

Emri i Lëndës : Etika e Medias dhe Legjislacioni							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
COM 303	B	Vjeshtë	3.00	0.00	0.00	3.00	5.00
Lektori		Mentor Kikia, Msc					
Asistenti							
Gjuha e kursit		Shqip					
Niveli i lëndës		Bachelor					
Përshkrimi		Përveç të drejtave dhe detyrimeve ligjore, mediat kanë edhe nje pergjegjesi morale,etikenë informimin dhe komunikimin e publikut duke ndikuar drejtperdrejtë në formimin e personalitetit të njeriut por edhe në zhvillimin e gjithë shoqërisë dhe jetës demokratike. Kursi në të gjitha modulet e tij mbeshtetet në parashtrimin e argumentave se komunikimi mediatik, informimi kanë gjithmonë si parakusht respektimin e deontologjisë e etikës profesionale. Parë në këtë këndvështrim, lenda është e ndertuar mbi debate interaktive mbi liritë dhe pergjegjësitësi dy shtylla të rëndësishme në kërkimin e së vertetës,informimin dhe komunikimin publik. Ndërthurja e elementeve teorike me çeshtje e raste konkrete nga media e huaj e shqiptare, të prezantuara shpesh nga vetë studentët i ndihmon ata të reflektojnë ,të komunikojnë e të gjejnë një përgjigjetë dilemave etike te përgjegjësia profesionale,te lira e informimit duke respektuar të drejtat e liritë individuale dhe deontologjinë profesionale. Në funksion të nxitjes së debatit dhe reflektimit mbi çeshtje të ngritura,do të bëhet e mundur edhe prania gjatë orëve e personaliteteve të ndryshme nga fusha e gazetarisë ,të drejtave të njeriutdhe jurisprudenca.					
Objektivat		•Kjo lendë do të ndihmojë studentët të kuptojnë: -Përveç të drejtave dhe detyrimeve ligjore,mediat kanë edhe nje pergjegjesi morale ,etike në informimin dhe komunikimin e publikut duke ndikuar drejtperdrejtë në formimin e personalitetit të njeriut por edhe në zhvillimin e gjithë shoqërisë dhe jetës demokratike. -Deontologjia e medias është një tërësi parimesh e regullash profesionale të detyrueshme për tu zbatuar e që e ndihmojnë gazetarin t'i japë përgjigje dilemave të caktuara etike me të cilat ndeshet çdo ditën e kërkimt të së vërtetës. -Të njohë,të respektojë legjislacionin mbi të drejtën e lirinë e shprehjes por edhe mbi respektimin e të drejtave të njeriut. -Të ndihmojë studentët për t'u përgatitur për situata të ndryshme etike me të cilat mund të ndeshen në ushtrimin e profesionit. -Të kuptojnë se e drejta e informimit i përket edhe publikut që kërkon që informacioni i dhënë nga gazetari të transmetohet,të komentohet me ndershmëri profesionale,larg manipulimeve,spekullimeve,interferencve politike e sociale që mund të nxisin reagime të ndryshme në një shoqëri të hapur. Lenda synon një riafirmim të vlerave etike morale,kodeve deontologjike duke zhvilluar qëndrimet profesionale dhe aftësitë personale të nevojshme për përgatitjen e studentëve si specialistë të komunikimit					
Konceptet Kryesore							
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Prezantimi i literaturës dhe burimeve bazë të lëndës, prezantimi i syllabus dhe mënyrës së vlerësimit.Partimet bazë të etikës në media. Çfarë është etika, ndryshjimi nga ligji për median dhe detyrimi për zbatimin e këtyre parimeve.						
2	Media dhe publiku, dramatizimi i ngjarjeve të zakonshme dhe pasojat e saj dhe viktimat e abuzimit mediatik						
3	Etika në marrëdhëniet me bashkëpunëtorët.						

4	Etika individuale dhe organizative. Raporti mes gazetarit dhe medias ku ai punon, përballë publikut.
5	Ligji për median. Kufizimet dhe liritë e medias në Shqipëri
6	Dekriminalizimi i shpifjes. Si ka ndikuar në lirinë dhe profesionalizimin e gazetarëve
7	Privatësia. Gazetaria investigative dhe rreziku i cënimit të lirisë së tjetrit përmes kameras së fshehtë
8	Provim Gjysmëfinal
9	Raportimi i lajmit në fushatën elektorale. Dilemat dhe sfidat etike në mbulimin e lajmit në fushatë elektorale
10	Etika në publikimin e fotove dhe videove. Raportimi i lajmeve të kronikës së zezë
11	Mediat mes ligjit dhe etikës. Roli dhe qëndrimi i medias për çështjet e sigurisë kombëtare
12	Konfidencialiteti, besnikëria dhe besueshmëria e lajmit
13	Manipulimi i publikut dhe fabrikimi i ngjarjeve
14	Marrëdhëniet publike dhe fenomeni produkteve të gatshme mediatike
15	Etika në median online dhe rrjetet sociale
16	Provim Final
Parakushtet	
Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.	
Literatura	
• Gazetaria- Stephan Russ-Mohl • Etika ne media	
Referenca të tjera	
• Media Law/Handbook series/http://www.america.gov/publication/books/media-laww.htm • McLuhan, Marshall, Instrumentat e Komunikimit, Instituti i Dialogut dhe Komunikimit • Dominick R., Joseph, Dinamika e komunikimit masiv, Media në periudhën digjitale, UET Press, 2011 • Kod etik/Gazetaria Invetigative/gshg/Tiranë,2004 • Kod etik/Media dhe trafiku/gshg/Tiranë 2002 • Udhëzues praktik/Deontologjia dhe etika e raportimit gjatë fushatave elektorale/Beder/R.Cipuri/B.Mema • Kronel.S.Shilla/Të gëmosh thellë/Sarajeve 2009/osce • Etika e mediave në epokën e digjitalizimit - Albanian Media Institute/www.institutemedia.org/.../A.Vehbiu • Mediat e Reja dhe Web 2.0 : Observatori European i Gazetarisë/ al.ejo-online.eu/category/mediat-e-reja-dhe-web-2- • Balle,Francis MediatdheShoqëritë, Botimii 15, Papirus, 2011 • Bertrand, Claude-Jean /Deontologjia e Mediave/ISHM/Tiranë 2007 • Patterson, Philip, Wilkins, Lee /Etika ne media/Tiranë 2009	
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Të fitojnë parimet bazë të etikës në media dhe të dallojnë ndryshimet mes ligjit për median dhe parimeve etike, që shërbejnë për normimin e punës së përditshme të gazetarit
2	Të njihen konkretisht me shembuj të cënimit të etikës nga ana e gazetarëve dhe pasojave që ajo ka shkaktuar tek personat e prekur.
3	Të fitojnë njohuri të përgjithshme mbi normat e etikës profesionale e personale , sjelljen e gazetarit në publik si pjesë e punës për krijimin e statusit të tij si person publik

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	30	
Kuize	0	0	
Projekte	0	0	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	1	10	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			40
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			60
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	3	48
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	4	56
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	8	8
Provimi final	1	10	10
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			122
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			4.88
ECTS			5.00